

Francis Plouffe




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ___ / ___ / 2024

Lënda: Depozitim projektligji.


Drejtuar: Znj. Lindita NIKOLLA
Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë

E nderuar Znj. Kryetare,

Bazuar në nenin 81 pika 1, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe nenin 68, të Rregullores së Kuvendit, Ju paraqes projektligjin “ Për një ndryshim në ligjin nr. 9967, datë 24.7.2008, “Për miratimin e aktit normativ nr. 4, datë 9.7.2008, “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”, të ndryshuar”.

Ju faleminderit.

DEPUTETI PROPOZUES


EDVARD SIANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKT LIGJ

Nr. _____, datë ____ . ____ .2024

**“PËR
NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 9967, DATË 24.7.2008,
“PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV NR. 4, DATË 9.7.2008, “PËR
PRIVATIZIMIN DHE DHËNIEN NË PËRDORIM SHOQËRIVE TREGTARE DHE
INSTITUCIONEVE SHTETËRORE TË NDËRMARRJEVE APO OBJEKTEVE TË
VEÇANTA, MJETEVE KRYESORE DHE MJETEVE TË XHIROS SË KËTYRE
NDËRMARRJEVE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës, me propozim deputeti,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 9967, datë 24.7.2008, “Për miratimin e aktit normativ nr. 4, datë 9.7.2008, “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”, të ndryshuar”, ndryshimin si më poshtë:

Neni 1

Në ligjin nr. 9967, datë 24.7.2008, “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”, i ndryshuar, në nenin 4 togfjalëshi “në Ministrinë e Financave” zëvendësohet me togfjalëshin “*në ministrinë përgjegjëse për ekonominë*”,

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 dite pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE

LINDITA NIKOLLA

Miratuar, më datë ____ 2024

RELACION
PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR

**NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 9967, DATË 24.7.2008, “PËR
MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV NR. 4, DATË 9.7.2008, “PËR
PRIVATIZIMIN DHE DHËNIEN NË PËRDORIM SHOQËRIVE
TREGTARE DHE INSTITUCIONEVE SHETËRORE TË
NDËRMARRJEVE APO OBJEKTEVE TË VEÇANTA, MJETEVE
KRYESORE DHE MJETEVE TË XHIROS SË KËTYRE
NDËRMARRJEVE”, I NDYSHUAR”**

**I. QËLLIMI I PROJEKTVENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË
SYNOHEN TË ARRIHEN**

Qëllimi i këtij projektligji është transferojë procedurë e shitjes së pronës publike nga Ministria e Financave te Ministria përgjegjëse për ekonominë.

**II. VLERËSIMI I PROJEKTVENDIMIT NË RAPORT ME
PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME
PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTEVE TË
TJERA POLITIKE**

Projektakti nuk është parashikuar në programin analitik të akteve për vitin 2024 të miratuar.

**III. ARGUMENTIMI I PROJEKTVENDIMIT LIDHUR ME
PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Në kushtet kur me daljen e akteve ligjore e nënligjore, përkatësisht:

1. me VKM-në nr.30, datë 17.01.2024, e cila ka miratuar fushën e përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, është përcaktuar që kjo ministri është përgjegjëse për “e) administrimin e pronës shtetërore”;
2. me VKM-në nr.31, datë 17.01.2024, e cila ka miratuar fushën e përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Financave; si dhe

3. me zbatimin e ligjit nr. 66/2023 “Për administrimin e objekteve të konfiskuara si ndërtime pa leje me qëllim përdorimin e tyre për interes publik apo strehim social si dhe zbutjen e pasojave të shkaktuara”, në fuqi, i cili për shitjen e objekteve të konfiskuara ngarkon “...ministrinë përgjegjëse për administrimin e pronës shtetërore nëpërmjet strukturës së shitjes së pronës publike” (neni 20, pika 3 e ligjit);

lind nevoja e harmonizimit të dispozitave, me qëllim që strukturat shtetërore të ushtrojnë detyrat e tyre funksionale, të papenguara nga përplasja e dispozitave apo paqartësitë që lindin në zbatimin e tyre.

Propozimi i këtij projektligji është të mundësojë që procedurat që lidhen me administrimin e pronës publike, përfshirë shitjen e saj, të kryhen nga një strukturë e vetme, e konkretisht te ministria përgjegjëse për ekonominë, e cila aktualisht ka si funksion të saj drejtimin, administrimin dhe privatizimin e pronës publike.

Gjithashtu theksojmë se shitja e pronës publike e përfituar nga objektet e konfiskuara sipas ligjit nr. 66/2023, realizohet nga ministria përgjegjëse për ekonominë ndërsa nga ana tjetër shitja e pronës publike sipas ligjit që po propozohet për ndryshim realizohet nga Ministria Financave.

Prandaj vlerësohet e domosdoshme harmonizimi legjislativ dhe delegimi i procedurës së shitjes në një institucion të vetëm, proces i cili krijon efikasitet dhe leverdishmëri administrative, pasi aktualisht sot janë krijuar dy struktura që merren me shitjen e pronës publike, proces i cili pasjell kosto të panevojshme për buxhetin e shtetit.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI, VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj bazohet në nenet 78 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS TË BE-SË (PËR PROJEKT AKTET NORMATIVE)

Projektligji nuk transponon ndonjë akt të veçantë të acquis të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT

Në projektligjin e propozuar parashikohen:

Neni 1 përcakton se:

Në ligjin nr. 9967, datë 24.7.2008, “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndër-marrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”, i ndyshuar, në nenin 4 togfjalëshi “në Ministrinë e Financave” zëvendësohet me togfjalëshin “*në ministrinë përgjegjëse për ekonominë*”,

Neni 2 përcakton që:

Ky ligj hyn në fuqi 15 dite pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E KËTIJ PROJEKTVENDIMI

Për zbatimin e këtij ligji, ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTVENDIMI

Projektligji është nismë deputeti.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE.

Projektligji nuk ka efekte financiare për Buxhetin e Shtetit.